



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AUTORITETI I KONKURRENCËS

Nr. Prot 643  
Tiranë, më 12. 11. 2018



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. Prot 4515  
Tiranë më 12. 11. 2018

### **MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**

#### **NDËRMJET:**

**Autoritetit të Konkurrencës (AK)** përfaqësuar nga Kryetari zj. Juliana LATIFI, dhe **Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)** përfaqësuar nga Kryetari z. Gentian SALA, që më poshtë ju referohemi me termin “Palët”:

Në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, dhe në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Duke njojur rëndësinë e mbrojtjes së konkurrencës dhe rëndësinë e rregullimit të veprimtarisë audio dhe/ose audiovizive.

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit në fushën e konkurrencës dhe atë të mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Shprehin gatishmërinë të rrisin dhe forcojnë bashkëpunimin, për çështje të interesit të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për konkurrencën në fushën e mediave audio dhe/ose audiovizive.

Palët e këtij Memorandumi Mirëkuptimi (më poshtë **“Memorandumi”**) bien dakord të bashkëpunojnë me qëllim të shkëmbimit të përvojës dhe informacionit si më poshtë vijon:

## **Neni 1**

### **Shkëmbimi i informacionit**

- AMA dhe AK shkëmbejnë informacionin e nevojshëm, të cilin pala marrëse e ruan me të njëjtin nivel konfidencialiteti, si pala dërguese.
- Shkëmbimi i informacioneve bëhet sipas përcaktimeve në ligjet respektive të konkurrencës dhe për mediave audiovizive, Kodit të Procedurave Administrative dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në momentin e nënshkrimit të këtij memorandumi.
- Angazhimi reciprok për hartimin e akteve nënligjore dhe ligjore në fushat respektive të mbuluara nga palët.
- Procesi i shkëmbimit të informacionit do të bazohet në parimin e besueshmërisë reciproke, transparencës mes palëve për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi, efikasitetit në përshtypjen e kohës së shkëmbimit të informacionit dhe vullnetit pozitiv për të vënë në dispozicion informacionin e disponueshëm konform legjislacionit.
- Secili nga palët duhet të garantojë konfidencialitetin e marrë nga pala tjetër. Informacioni i marrë në kuadër të këtij memorandumi nuk mund të transferohet një pale të tretë pa pasur një autorizim me shkrim nga pala e cila ka siguruar informacionin.

## **Neni 2**

### **Përgjegjësitë e Autoritetit të Mediave Audiovizive**

1. AMA në funksion të përbushjes së detyrimeve të tij ligjore, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, do të vendosë kushte për garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e mediave audiovizive në përputhje me ligjin e konkurrencës në tregun shqiptar.
2. Në veprimtarinë e tij, AMA vlerëson rezultatet e zhvillimit në fushën e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive dhe analizon efektet e ndryshme në tregun e transmetimeve si dhe bashkëpunon me AK për vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës për shpalljen ose jo të një operatori, me pozitën dominuese sipas legjislacionit të konkurrencës.
3. Nëse AMA konstaton se një operator (OSHMA) në tregun e mediave audiovizive abuzon me pozitën e tij në treg, e parashtron rastin pranë AK, duke i kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore.

## **Neni 3**

### **Përgjegjësitë e Autoritetit të Konkurrencës**

1. AK në funksion të përbushjes së detyrimeve të tij ligjore, në zbatim të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, do të nxisë forcimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e mediave audiovizive.
2. AK për arsyet e interesit të përgjithshëm, vlerëson në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ. Në këto raste Autoriteti bën rekomandimet përkatëse.
3. AK për zbatimin e ligjit të sipërcituar në sektorin e mediave audiovizive mund të bashkëpunojë me AMA-n lidhur me përcaktimin e tregjeve përkatëse dhe dokumentet e analizës së tregjeve.

4. AK mund të kërkojë opinionin e AMA-s në fushën e mediave audiovizive lidhur me aktet nënligjore, rregullore dhe udhëzues i referohem përcaktimit të tregjeve përkatëse të produktit dhe atij gjeografik, shpalljes së një ose operatorëve me pozitë dominuese në tregjet përkatëse dhe analizës së konkurrencës në këto tregje.

**Neni 4**  
**Grupet e përbashkëta të ekspertëve**

Palët mund të ndërtojnë grupe të përbashkëta pune sipas ekspertëve, sipas nevojës, *ad-hoc*, për aspektet e analizës së tregjeve, procedurave të inspektimit apo bashkëpunimit ndërinstitucional për çështje të karakterit të përbashkët sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Secila palë i mbart shpenzimet e veta lidhur me ekspertët e saj.

**Neni 5**  
**Organizimi i konferencave**

Palët kur është e përshtatshme do të informojnë dhe do të ftojnë në workshope, seminare, simpoziume dhe konferanca kombëtare dhe/ose ndërkombëtare të organzuara nga palët, Komisioni European, OECD etj. apo autoritetet simotra të vendeve të rajonit, BE e më gjërë.

**Neni 6**  
**Koheranca e takimeve mes palëve**

Titullarët e palëve respektive do të takohen në rast nevoje për sa i përket implementimit të këtij memorandumi në mënyrë që të rendisin prioritetet e bashkëpunimit brenda kësaj kornize dhe vazhdimin e tij, shkëmbim pikëpamjesh dhe ato sipas mundësive, do të ndërmarrin veprime dhe pozicione të përbashkëta në forume dhe organizata evropiane ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me sektorin e mediave audiovizive.

**Neni 7**  
**Analiza e zbatimit të Memorandumit**

Palët do të shqyrtojnë në baza dyjetore, rezultatet e bashkëpunimit të tyre sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit. Palët do të ndërmarrin hapa për përmirësimin e bashkëpunimit dhe do të bëjnë propozime të përshtatshme për të ndryshuar fushën e veprimit të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

**Neni 8**  
**Pikat e kontaktit**

1. Në dhe për zbatim të kësaj marrëveshje, personat e kontaktit do të jenë:

- a. Për AK              Thomas Koleka  
thomas.koleka@caa.gov.al  
Tel: 0692192608
- b. Për AMA-n        Eriona Rusmali  
Eriona.rusmali@ama.gov.al  
Tel: 0674040888

**Neni 9**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e poshtëshënuar dhe mund të ndërpritet nga secila palë, duke njoftuar palën tjetër paraprakisht në një afat kohor prej 1(një) muaji.

U firmos dhe hyn në fuqi në datë 12. 11.2018.

PËR

AUTORITETIN E KONKURRENCËS

KRYETAR

JULIANA LATIFI



PËR

AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE

KRYETAR

GENTIAN SALA

